



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

PËR VERIFIKIMIN E DEKLARIMEVE NË FORMULARIN E VETËDEKLARIMIT TË KANDIDATËVE NGA LISTAT SHUMEMËRORE PËR KËSHILLAT BASHKIAK NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 138/2015 "PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE", PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30 QERSHOR 2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 17.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me,

OBJEKT: Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve të listave shumemërore për këshillat bashkiak, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", për zgjedhjet për organet për qeverisjen vendore të datës 30 qershor 2019.

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa "a", i Ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; neni 5, pika 4, germa "a" i ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; kreu V, i vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,



Nr . 481 i vendimit Data 17.05.2019 e vendimit Ora 12:00 e vendimit

"Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve të listës shumemërore për Këshillat Bashkiak, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

VËREN

Partia Aleanca Demokratike, pjesëtare e Koalicionit "Aleanca për Shqipërinë Europiane", në përputhje me nenin 5, pika 4, germa "a" të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularët e vetëdeklarimit, të kandidatëve për këshillin e bashkisë Kukës, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", KQZ verifikoi të dhënat në formularët e vetëdeklarimit për secilin kandidat të listës shumëmemërore. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, rezulton se asnjë prej kandidatëve nuk kanë deklaruar asnjë të dhënë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe kreut V, pika 2, germa "b" dhe pikës 3, germa "c", të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore dhe zyra e gjendjes civile nëpërmjet shkresave si dhe nëpërmjet postës elektronike për kandidatët për anëtarë në këshillat bashkiak, që kanë dorëzuar formularët e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Zyra e gjendjes gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për të kandidatët për anëtarë në këshillat bashkiak, sipas së cilës rezultojnë se kandidati i regjistruar në listën shumëmemërore Bashkia Kukës **me numër rendor 07, z. Altin Duraku:**

Në bazë të vendimit nr. 82, datë 30.08.1996 Gjykata e Kukësit, e ka deklarur fajtor për veprën penale të "vjedhjes në bashkëpunim" parashikuar nga neni 134 e 35 të K.Penal dhe në bazë të kësaj dispozite e dënon me 1 (një) vit burgim, në bazë të nenit 51 të K.Penal e dënon përfundimisht të pandehurin Altin Duraku e dënon me 6 muaj.

Shënim: Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr.792, dt.11.10.1996 është vendosur lënia në fuqi e vendimit nr. 82, datë 30.08.1996 të Gjykatës së Rrethit Kukësit
Rehabilitohet në bazë të nenit 69 të K.Penal.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, referuar pikës 2, paragrafi i fundit, të kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstaton se për personat e shënuar në listën shumëmemërore të dhënat e tyre nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin si kandidatit për këshillin e bashkisë, sipas ligjit nr. 138/2015. KQZ gjithashtu ka bërë publikimin e formularëve të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Referuar nenit 33, germa "f" të Kodit Zgjedhor, Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor ka kompetencën për regjistrimin e kandidatëve për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, në ato bashki të cilat administrohen nga një KZAZ.

Referuar ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe pikës 5/1, 6 të nenit 9 të udhëzimit nr.2, datë 29.01.2013



Nr . 481 i vendimit Data 17.05.2019 e vendimit Ora 12:00 e vendimit

"Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve të listës shumëmemërore për Këshillat Bashkiak, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

“Për caktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit dhe afatet për publikimin e listave të kandidatëve”, KZAZ duhet vazhdojnë procedurat për rregjistrimin e listës shumemërore për këshillin e Bashkisë Kukës, të Partisë Aleanca Demokratike për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1, germa “a”, e ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; nenin 5, pika 4, germa “f”, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; kreu V, i Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

VENDOSI:

1. Njoftimin e KZAZ-së nr. 11, për vazhdimin e procedurave për rregjistrimin e listës shumemërore për këshillin e Bashkisë Kukës, Partia Aleanca Demokratike për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare



Nr . 481 i vendimit Data 17.05.2019 e vendimit Ora 12:00 e vendimit

“Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve të listës shumemërore për Këshillat Bashkiak, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.